

E DREJTA PARLAMENTARE DHE POLITIKAT LIGJORE

2001

Në këtë numër:

Opinione për Politikat Ligjore

- Akti i Lirisë së Shtypit

E Drejta Parlamentare

- Iniciativa ligjvënëse e deputetëve:
Instrument real apo formal
- Roli i specialistëve dhe i shoqërisë civile në procesin e hartimit të projektligjeve

3

**Botimi i Qendres Studimore
Mbi Praktikat Parlamentare
Dhe Demokratike**

PERMBAJTJA E REVISTES:

Numri III, viti 2001

Faqe

Opinione mbi politikat ligjore:

Anarkia si e kundërt me lirinë e shtypit	
- Halil Lalaj, Deputet, Kryetar i Komisionit të Përhershëm për Mjetet e Informimit Publik	5
Një nismë e domosdoshme ligjore	
- Teodor Laço, Deputet, Anëtar i Komisionit të Përhershëm për Mjetet e Informimit Publik	12
Një ligj për shtypin apo kundër shtypit? Debat mbi projektligjin “Akti i Lirisë së Shtypit”	
- Alban Bala, Korrespondent i radios “Europa e Lirë”	16

Informacion mbi legjisllacionin e miratuar në Kuvend	23
E Drejta Parlamentare	

Iniciativa ligjvënëse e deputetëve: Instrument real apo formal?	31
- Haxhi Aliko, Deputet	
Roli i specialistëve dhe i shoqërisë civile në procesin e hartimit të projektligjeve	36
- Njazi Jaho, Jurist, Komiteti Shqiptar i Helsinkit	

Informacion mbi veprimtaritë e organizmave ndërkombëtare. Leon Shestani	42
Botime të Kuvendit	

Një fillim i mbarë...	46
- Zana Bufi, Kuvendi, Sektori i Kërkimit dhe Biblioteka	

Përmbledhja e përkthyer në anglisht:	48
- Opinione mbi politikat ligjore	
- Informacion mbi legjisllacionin e miratuar në Kuvend	

TABLE OF CONTENTS:

3rd Issue, year 2001

	Page
Opinions about Legal Policies:	3
Anarchy, opposite of freedom of media	5
- Halil Lalaj, MPs, Chief of Parliamentary Committee for Means of Public Information	
A necessary legal initiative	12
- Teodor Laço MPs, Member of Parliamentary Committee for Means of Public Information	
A Law in favor or against the press? Debate about the draftlaw “Act of Press Liberty”	16
- Alban Bala, journalist	
Information on Laws Passed by Assembly	23
Parliamentary Law:	
Legal Initiative of MPs: a formal or real instrument?	31
- Haxhi Aliko, MPs	
Role of Experts and Civil Society in the legislative drafting process	36
- Njazi Jaho, Lawyer, Albanian Helsinki Committee	
Information about International Assemblies’ Activities, Leon SHESTANI	42
Publications of the Assembly:	
A good start..	46
- Zana Bufi, Sector of Research and Library, Assembly	
Summary in English :	48
- Opinions about Legal Policies	
- Information about Laws Passed by the Assembly	



Kjo rubrikë synon paraqitjen e politikave ligjore, në mënyrë të paanshme dhe objektive. Publiku dhe subjektet e interesuara duhet të jenë të qartë për debatin politik dhe për qëndrimet e forcave të ndryshme politike për çështje të rëndësishme që prekin interesa të një kategorie të gjerë njerëzish. Publiku është njëkohësisht dhe zgjedhësi, dhe, në këtë kontekst ai duhet të ndërgjegjësohet për qëndrimet dhe pikëpamjet e forcave të ndryshme politike. Në këtë numër të Revistës është përzgjedhur projektligji “Për Prokurorinë në Republikën e Shqipërisë” si një çështje ligjore e rëndësishme në kuadrin e reformave institucionale në vendin tonë.

Anarkia si e kundërt me lirinë e shtypit

Nga Halil Lalaj

Deputet

Kryetar i Komisionit të Përhershëm

për Mjetet e Informimit Publik

Grupi Parlamentar i PS

Që kur më 3 shtator 1997 u shfuqizua ligji i atëhershëm i shtypit e deri më sot, nuk është plotësuar ende detyrimi i vetëm i një neni të vetëm të mbetur, sipas të cilit “Liria e shtypit mbrohet me ligj”. Komisioni i Përhershëm për Mjetet e Informimit Publik i Kuvendit të Shqipërisë, në bashkëpunim me Institutin e Studimeve Publike dhe Ligjore, jo thjesht për të përmbushur një detyrim të paplotësuar, ngarkoi një grup pune të cilit i vuri detyrë t’u paraqiste gazetarëve një projekt për të diskutuar bashkërisht rreth tij. Tashmë, për më se dy muaj ky projekt është në duart e njerëzve të medias, jo vetëm përmes publikimit në një nga organet e shtypit të përditshëm dhe në revistën “Media Shqiptare”, por edhe si botim i veçantë. Njëherësh, me projektin janë njohur edhe organizma e organizata profesioniste të fushës, veçojmë këtu Artikullin XIX (Londër), Institutin e Shoqërisë së Hapur (Budapest) dhe organizma politikë, si Këshilli i Evropës dhe OSBE-ja.

Çfarë është arritur dhe ç’përmban në vetvete ky projekt?

Si rregull, një ligj i çfarëdoshëm synon disa norma rregulluese, të cilat në vetvete përbëjnë në një farë mase edhe kufizime, për t’u vënë në shina kjo ose ajo fushë e veprimtarisë përkatëse. Përsa i përket projektit për ligjin e shtypit, puna është disi më ndryshe. Në rastin në fjalë, parësore nuk është si të caktohen rregulla kufizuese për fushën, d.m.th. kufizime për shtypin, por kufizime për të tjerët, me synimin e shpallur që në ballafaqimin e tij me cilindo pushtet tjetër, shtypi të ndjehet realisht i mbrojtur.

Kjo është ana parimore e problemit. Për t'u realizuar është gjetur edhe praktika përkatëse. Konkretisht, u zgjodhën për t'u marrë në shqyrtim ligjet e disa vendeve: italiane, gjermane, çeke, daneze, norvegjeze e suedeze, bashkë me ekspertiza të ndryshme dhe një numër rekomandimesh të organizmave politike, si Këshilli i Europës ose të organizatave ndërkombëtare profesioniste. E vërteta është se këto ligje, që janë në përdorim në vendet e sipërpërmendura, janë pak a shumë të përafërta, por edhe diferencat nuk janë të pakta. Një vëzhgim i kujdesshëm i veçon ato pa vështirësi.

Pasi u zgjodhën pikat më të rëndësishme të fushës që kanë nevojë për rregullim, ekspertët ishin të një mendjeje për t'u marrë zgjidhjet ose përcaktimet përkatëse më të spikatura, njëherësh më të përparuara, me qëllim që ato të bëheshin pjesë e ligjit shqiptar. Gjithashtu, u përkujdesëm të përfshinim sa të ishte e mundur edhe disa nga rekomandimet e organizmave të ndryshëm profesionale ose politike, lindur vitet e fundit si refleks i praktikave zbatuese, por që ne nuk i kishim hasur në ligjet e konsultuara.

Përmes këtyre dy anëve, në funksion të qëllimit kryesor të shpallur, pra, për një liri garantuar të shtypit dhe mbrojtje të posaçme ligjore të gazetarëve në funksionin e tyre për informimin e publikut, "Akti i Lirisë së Shtypit" synon të rregullojë marrëdhënie të rëndësishme, siç janë ato midis shtypit dhe publikut ose midis gazetarit dhe lexuesit, midis gazetarit dhe shtetit, po deridiku, së paku në linjat më kryesore, edhe midis gazetarit e punëdhënësit të tij dhe, së fundi, marrëdhëniet me Urdhrin e Gazetarit, si autoritet rregullues.

Projekti është i konceptuar në dy pjesë dhe secila prej tyre ka katër kërre të shkurtër. Në kreun "E drejta për informim" mund të veçonim nenin 16, që bën fjalë për *mbrojtjen e burimit të informacionit*, si pjesë e kësaj të drejte. Në të gjitha ligjet e konsultuara ky nen gjendet i përfshirë. Diferencat na kanë nxitur të kërkojmë më të avancuarën. Në të vërtetë, ligji çek na u duk më i përshtatshmi për ta pasur si bazament në zgjedhjen që ne do të bënim. Ndoshta edhe për faktin se një ekspertizë e Këshillit të Europës

kishte vërejtur një hap të rëndësishëm në atë ligj, sipas të cilit të drejtën e mbrojtjes së burimit ua garantonte jo vetëm gazetarëve, por edhe personave të tjerë që, për shkak të lidhjeve profesionale me gazetarin, marrin pjesë në përgatitjen e informacionit. Megjithatë grupi i punës shkoi më tej, duke marrë jo vetëm përcaktimin e mësipërm, por përfshiu edhe një rekomandim të Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve, sipas të cilit duhet të vihen në mbrojtje jo vetëm pohimet e të dhënat e mbledhura, por edhe ato që quhen prova materiale, kërkesë që nuk ndeshet në ligjet e shqyrtuara. Përsa u përket kufizimeve të këtij çasti, që i përmban çdo legjislacion, janë përfshirë vetëm rastet më të skajshme, kur bëhet fjalë për zbulimin e autorëve të krimeve të rënda kundër jetës e shëndetit të njerëzve ose kur bëhet fjalë për krime të rënda e kur janë konsumuar të gjitha rrugët e tjera për zbulimin e tyre, gjë për të cilën është gjykata ajo që vendos.

Gjithnjë kemi pasur mendimin se në projektligj janë zbatuar përkufizimet më të përparuara. Le të marrim p.sh., nenin 27 “*Kufizimi i përgjegjësisë penale të shtypit*”. Në këtë nen, në përputhje edhe me Kodin Penal, si dhe me procedurat e parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale, jepet e drejta për hapa të skajshëm, siç është bllokimi i shpërndarjes së shtypit kur është fjala për vepra që provokojnë luftë, thirrje për armatosje, nxitje të urrejtjes dhe të grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve, thirrje për urrejtje nacionale ose përhapje të informatave të rreme e që ngjallin panik. Deri këtu nuk ka asgjë të re në formulim, sepse kjo ndeshet thuajse në të gjitha ligjet e cilitdo vendi dhe është gjetur në pajtim edhe me nenin 10 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut ku, krahas afirmimit të së drejtës së individit për të kërkuar, marrë e përhapur informacion dhe ide, me çfarëdo mjeti dhe pavarësisht nga kufijtë, parashikohen edhe kufizime kur është fjala për sigurinë kombëtare, sigurinë publike, mbrojtjen e dinjitetit të të tjerëve etj. Të gjitha këto janë të njohura, siç është mjaft interesante të vëresh se si luhet në këtë hapësirë kufizimesh jo vetëm nga media me mënyrat e saj rrëshqitëse, por edhe nga të gjitha gjykatat, nga më të ultat e deri në Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Edhe në këtë çështje nuk ka pse të mos e nënvizojmë një të veçantë, çka në të vërtetë është një përgjigje për një pyetje praktike: Cili do të jetë qëndrimi kur burimi i thirrjes për dhunë, nxitje urrejtjeje etj. etj. nuk vjen nga kjo ose ajo gazetë, ky ose ai subjekt transmetues radioteleviziv? Edhe për këtë pikë ligjet e konsultuara nuk e japin një përgjigje, ndonëse shqetësimi është ngritur prej kohësh nga Qendra Ndërkombëtare kundër Censurës (Artikulli XIX). Është kjo arsyeja që grupi u nxit të formulojë një dispozitë si kjo: “Me përjashtim të dispozitave penale për bashkëpunimin, organi i shtypit ose drejtuesit e tij, përjashtohen nga ndjekja penale në të gjitha rastet kur transmetojnë ide, pikëpamje, komente dhe opinione të tjerëve, të cilat përbëjnë vepër penale, në qoftë se kanë evidencuar qartazi autorin e ideve, pikëpamjeve, komenteve ose opinioneve, si dhe dukshëm kanë përjashtuar çdo lidhje të tyre me përmbajtjen e ideve, pikëpamjeve, komenteve dhe opinioneve, të specifikuar si më sipër” (Neni 27, pika 2).

Mund të vijojnë argumentet në dobi të idesë se në këtë projekt vërtet janë parapëlqyer dispozita nga më mbështetëset për shtypin. Mund të bindemi për këtë duke iu drejtuar përsëri një çasti të skajshëm, siç është *censura paraprake*, të cilën e ndalojnë të gjitha kushtetutat demokratike. Por ama të gjithë kanë formuluar edhe rastet përjashtimore. Kështu edhe ligjet e konsultuara i numërojnë rastet kur mund të konfiskohet një botim. Projekti në fjalë përsëri e tenton një vështrim të vetin, që në thelb do të thotë: botimi nuk i nënshtrohet kurrfarë censure, ajo mund të zbatohet vetëm në shpërndarje. E veçanta është se kur një organ shtypi diku gjetkë konsumon, bie fjala, veprën e thirrjes për dhunë, shteti ndërhyt jo vetëm për të ndaluar shpërndarjen e botimit, por bllokton e sekuestron edhe disketa, lastra, filma, kaseta e gjithçka tjetër që ka të bëjë me materialin objekt i sekuestros. Projekti ynë këtë aspekt e ka përjashtuar.

Të mos keqkuptohemi. Nuk mendojmë se ky projekt përmban vetëm zgjidhjet më të mira dhe si i tillë është i paqortueshëm. Madje ka dispozita që duhen ndrequr, siç ka të tjera të diskutueshme. Në këta dy-tre muaj janë gjallëruar opinionet, siç bëhen edhe sugjerime dashamirëse. Tërheq

vëmendjen, për shembull, *e drejta për replikë*. Në fakt, ky kre është nga më të përpunuarit në projekt. Por po aq ka zgjuar diskutime e kundërshti, sidomos nga recensues të huaj. Arsyeja kryesore mendoj se vjen nga që jo të gjitha legjislacionet e praktikojnë atë, kështu është i pranishëm edhe disponimi për ta kundërshtuar. Gjithsesi, nëse praktika amerikane replikën e sheh si ndërhyrje në pavarësinë botuese, në Europë kjo e drejtë në përgjithësi funksionon rregullisht. Konventa Europiane për Televizionin Ndërkufitar, e ratifikuar nga Shqipëria më 1999, kërkon nga palët të ofrojnë në ligj të drejtën e replikës. Në atë Konventë thuhet: “Çdo palë transmetuese do të sigurojë që çdo person fizik ose juridik, pavarësisht kombësisë e vendbanimit, do të ketë mundësinë të ushtrojë të drejtën e replikës”.

Në të vërtetë e drejta për replikë vjen si kufizim për lirinë e shprehjes dhe si hapësirë për lirinë e individit. Pra, vihen përballë dy të drejta, të dyja të rrahura dhe të mbrojtura gjerësisht. Një barazpeshë midis këtyre dy të drejtave do të ishte shumë e dobishme. Një opinion i dytë, ndoshta disi më oportun, nuk e kundërshton replikën, por për mendimin tim i heq asaj lëngun, duke zbritur në përkufizime që i ngushtojnë hapësirat e saj, madje duke humbur fare kuptimi i mirfilltë dhe duke kaluar thjesht në korrektive faktesh e të dhënash. Prandaj dhe kundërshtohet prerë replika për opinionet. Po nëse ato janë fyese e denigruese? Logjika kundërshtuese thotë: “Shko në gjykatë, pasi atje ke mbrojtje sipas dispozitave penale për fyerjen e shpifjen.” Kjo është e vërtetë, madje në gjykatat tona janë dosjet mal me aktpadi për fyerje e shpifje dhe shpesh përfundimet kanë qenë të disfavorshme për gazetarët. Kjo është edhe një arsye që, nisur nga kushtet tona, të parapëlqejmë idenë e replikave detyruese, gjë që besojmë se shkarkon mjaft procese penale. Problemi, gjithësesi mbetet i diskutueshëm.

E diskutueshme nuk është vetëm kjo çështje. Ajo që ka zgjuar më shumë diskutime e kundërshti është pjesa e dytë e projektit, e cila përmban veprimtarinë rregulluese përmes Urdhrit të Gazetarit. Në të vërtetë, njëri nga nenet, pikërisht neni 33, ku kërkohet regjistrimi i detyrueshëm i gazetarëve në Urdhër, bie në kundërshtim me parimin e lirisë gazetareske

dhe me konceptin e gazetarisë si profesion i lirë. Grupi i punës, pas këshillimeve me ekspertë të fushës, është tërhequr tashmë nga ky koncept. Por mbetet për t'u përshtatur në një frymë tjetër, brenda koncepteve të anëtarimit vullnetar, çka është pranuar nga ekspertët e huaj, sidoqë ky çast parapëlqehet të bëhet më shumë me nisma vetërregulluese të gazetarëve, se sa nga lart, me ligje. Përvojat nuk mungojnë si për njëjërën dhe për tjetrën rrugë.

Megjithatë, pozicionet nga shtrihen kundërshtitë jo gjithnjë janë të besueshme e serioze. Ka mosnjohje, për shembull, të thuash se Këshilli Kombëtar i Urdhrit na u ngritka nga lart, nga Komisioni për Mjetet e Informimit Publik, kur ky Komision ka të drejtën për të ngritur vetëm një Këshill të Përkohshëm, për një vit, e që nga ana e vet ky i fundit nuk ka asnjë të drejtë tjetër veçse të hapë një regjistër të gazetarëve, na duket se shpreh mungesë dëshire për t'u njohur me ligjin. Organet e veta drejtuese nuk i zgjedh asnjë strukturë e shtetit, por vetëm gazetarët me votën e tyre. Por ka edhe një reagim, për të mos prishur në një farë mënyre një *statusquo*. Kjo është sidomos e ndjeshme te ata që drejtojnë shoqatat. Megjithatë, më mirë të jemi të rezervuar për komente.

Tashmë një debat është hapur, opinione janë dhënë nëpër konferenca, në shtyp e gjetkë. Besoj se ai ndihmon për të listuar më shumë argumente pro dhe kundër. Ligjvënësi ndjehet i gatshëm të zgjedhë atë variant që do të jetë më i pëlqyeshëm për masën e gazetarëve dhe më i përshtatshmi për rrethanat tona. Duke hedhur për koment disa linja, mendoj se ato janë edhe nevoja të fushës për t'u rregulluar me ligj. Sepse, në fund të fundit, na duhet të zgjedhim, e kemi për detyrë të zgjedhim midis nevojës për rregullim dhe anarkisë.

Duke komentuar atë çka sjell ky projekt për Lirinë e Shtypit, është e kuptueshme të mos ndash komentet për këtë çështje nga opinioni për gjendjen e fushës. Në këtë veshtrim, mund të themi se rrethanat e kanë sjellë median në rangun e njërit prej pushteteve nga më të privilegjuarit. Shoqëria e sotme vazhdon të vrasë mendjen si e si të forcojë dita ditës pushtetet, si të theksojë

pavarësinë e tyre nga njëri-tjetri si rruga më efektive e rritjes së përgjegjshmërisë së një shoqërie, për të përballuar sfidat. Por, paralel me këtë, njëherësh e vret po aq mendjen si të vërë rregulla funksionimi sa më të sakta, në mënyrë që rritja e pushtetshmërisë së pushteteve të ecë në kah të kundërt me mundësinë e abuzimit me pushtetin.

Me median ndodh disi ndryshe. Ndoshta për faktin se pushtetet e tjera, veç e veç ose marrë së bashku, të vetmen opozitë të shpallur kanë shtypin. Shoqëria e ka në vëmendje mbrojtjen e saj nga secili prej këtyre pushteteve ose aleancave midis tyre. Megjithatë, përvoja tregon se një minimum rregullash nuk e dobësojnë aftësinë mbrojtëse e as sulmuese të shtypit. Madje, ato vetëm e bëjnë atë më serioz e më të mprehtë. Mungesa e këtyre rregullave ligjore për shtypin, por edhe shpërfillja e disa rregullave etike, të shkruara e të pashkruara nga ana e këtij të fundit, kanë sjellë një shqetësim, çka shfaqet dukshëm në raportet e tij me shoqërinë. Është e rrezikshme kur shtypi si pasuri e shoqërisë dhe brenda diversiteteve të veta, nga opozitë ose oponentë me pushtetet, rrëshqet në kaos e anarki, deri në regres kundër vetvetes. Në çastet e para kjo gjendje sjell pështjellime në shtresa e grupime të ndryshme të shoqërisë, sjell shqetësime doemos edhe në struktura të ndryshme të shtetit. Por vjen një çast që mjedisi ngopet me banalen, të keqen, të ertën, me udhëkryqet, ngopet me sensacionin e manipulimin, deri atje sa të humbë ndjeshmërinë dhe të bëhet indiferent ndaj shtypit ose medias në përgjithësi.

Më duket se edhe ne jemi duke e vuajtur këtë gjendje dhe ky më ngjan se është një shqetësim i madh dhe që nuk mund të ndreqet me asnjë rrugë tjetër, me asnjë kod, përveçse me procese të reja brenda vetë bashkësisë së shtypit. Një masë mbrojtëse, një nga masat e rëndësishme, por jo e vetmja, për ta nxjerrë atë nga degradimi është edhe hartimi i këtij minimumi rregullash dhe gjetja e një mënyre që përgjegjësia e shtypit të jetë e vëzhgueshme dhe e monitorueshme, që edhe përgjegjshmëria e tij të vijë në rritje.

Një nismë e domosdoshme ligjore

Nga Teodor Laço

Deputet,

Anëtar i Komisionit të Përhershëm

për Mjetet e Informimit Publik

Grupi Parlamentar e Djathta e Qendrës

Nga pamundësia e një ligji të vërtetë për shtypin, i cili në shoqërinë totalitare shpallej hapur si një armë e partisë për edukimin komunist të masave punonjëse, te ligji i shtypit i vitit 1993, problematikë për disa sanksione të ashpra, tek ai i vitit 1997 që theu rekordin e çdo lakonizmi (“Shtypi është i lirë, liria e shtypit mbrohet me ligj”), deri te projekti “Akti i lirisë së shtypit” - 2001, ka kaluar më se një dekadë.

Ligji i vitit '93, një model i huazuar prej ligjit të një landi gjerman, u keqkuptua dhe në ndonjë rast u keqpërdor prej segmentesh të papërgjegjshme, për të ndëshkuar disa guxime gazetareske që delnin prej kornizave dhe që u interpretuan si “nxjerrje sekreti shtetëror”. Kam pasur ratin të shprehem në shtyp edhe në ato ditë kur u dënuan gazetarët e “Koha Jonë”. Megjithatë, po të përjashtojmë ndonjë paqartësi që krijonte penalizime, edhe ai ligj s’mund të thuhet se ishte antidemokratik.

Ligji i vitit '97, që e përmbloodhi gjithë thelbin e lirisë së shtypit në një seancë të marrë nga Kushtetuta e SHBA-së, në krye të herës, duket se i kënaqi profesionalistët e shtypit, por lehtësisht u kuptua se ky formulim, synonte më shumë të ëmbëlsonte pushtetin e katërt, sesa të zbatohet tepër seriozisht. Mirëpo, në një vend me tradita të pakta të lirisë, ku etika nuk përfillet, një ligj kaq i cunguar rrezikoi të mbillte anarki mediatike, “ha Muço pi Muço”, gjë që në ndonjë rast edhe ka ndodhur! Nga ana tjetër, ai nuk i përjashtoi penalizimet, sepse aktet që merren si shpifje ose fyerje

publike janë të parashikuara si çështje penale, ndërsa sipas shembujve më të mirë të botës, ato duhen trajtuar si çështje civile. Këtë vërejtje e ka bërë edhe ekipi i monitorimit të shtypit të organizmave të OKB-së.

Ndërkohë, prej 10 vjetësh nga njëri ligj te tjetri, nuk mund të quhet e madhe për një shtet ku gjymtyrët ecin në harmoni. Por ne s'mund të mburremi se gjendemi brenda kësaj kategorie të lartë qytetërimi, demokracie e drejtësie dhe as të këtij niveli qeverisjeje. Kjo ndërkohë mund të quhet “shumë” për një vend me tranzicionin më të turbullt nga ish-qerthulli lindor. Vëmendja e ligjvënësve dhe sidomos e Qeverisë, prej nga buron shumica e projekteve, duhej të kishte qenë më e madhe sepse, ndonëse kanë qenë të pranishme ligjet e përmendura, në të vërtetë mund të thuhet se shtypi ka ecur pa e pasur ligjin nëpër këmbë dhe nga ana tjetër, zyrtarët janë sjellë shpesh me shtypin në mënyrë emocionale ose politikisht të qëllimshme, pa e çarë kokën për lirinë e tij. Vetëkuptohet, një ligj i ri për shtypin, është i domosdoshëm, jo vetëm për shkak të pushtetit që ka shtypi por pikërisht sepse asnjë pushtet nuk mund të ushtrohet mirë dhe drejt pa pasur rregulla të gjithëpranuara. Përndryshe... rroftë anarkia!

Duke vëzhguar ndryshimet në mënyrën e të jetuarit dhe të të menduarit të qytetarit shqiptar gjatë kësaj demokracie të brishtë, nuk është e vështirë të vëresh se, krahas rritjes së interesit të tij për shtypin, gati si në një etje zhuritëse, si dhe një dozë jo e pakët naiviteti për ta besuar çdo gjë që nxin faqet e gazetave, pikërisht për shkak të kësaj “besueshmërie”, ka një zhgënjim kundërshtues sa herë duket ose provohet se informacioni ka qenë i rremë. Ethja e sensacionit dhe shpesh tendenca politike kanë sjellë në shtyp dyndjen e hamendjeve, të trillimit, të lajmit të sajuar ose thjesht të shpifjes. Shtypi duhet të matet mirë që të mos e teprojë zullumin në këtë fushë, përndryshe do t'i hapë gropën vetes! Gënjeshtra i ka këmbët e shkurtra, kurse këmbëngulja për ta përdorur shtypin si një armë që shkrehet nga supi, do s'do sjell humbjen e besimit të lexuesit, humbjen e interesit dhe rënien e tirazhit, gjë që ka ndodhur edhe këtu. Kjo marrëdhënie e re midis shtypit dhe konsumatorit të tij është një arsye tjetër e fortë për të përligjur paraqitjen e këtij akti.

“Akti i lirisë së shtypit” ka ngjallur diskutime, madje edhe fare të skajshme, deri në mospranimin e plotë të tij. Kjo është një provë më shumë për domosdoshmërinë e tij. Tani që projektin e kemi, të hartuar me më profesionalizëm dhe konsulencë sesa të mëparshmit, do t’ia vliente që me të të jemi të kujdesshëm dhe të mos sillemi si ata që bashkë me ujin e pistë, flakin edhe foshnjën.

Disa nënvizime të mijat, renditur sipas rrjedhës së projektit dhe jo sipas rëndësisë, do të ishin:

1. Përkufizimi i termit “gazetar” (neni 3/1) nuk është i plotë. Statusin e gazetarit mund ta kenë edhe individë që nuk merren në mënyrë ekskluzive me këtë profesion, njerëz që dikur e kanë ushtruar atë me sukses dhe më pas janë përkushtuar në fusha të tjera, por pa e lënë mënjanë “hobin” e tyre, sidomos, nëse aderojnë në shoqatat e njohura profesionale ose nëse gjendet ndonjë shteg që “Urdhri i gazetarit” të zerë vend jo si një detyrim i diktuar prej ligjvënësve, po si një dokument i pranuar e i nënshkruar prej vetë profesionistëve të gazetarisë. Mund të duket sikur përcaktimi i saktë i termit nuk ka shumë rëndësi, sepse me të ose pa të askujt nuk i ndalohet e drejta e të shkruarit, mirëpo, sa më përfshirës të jetë përcaktimi i termit, aq më shumë individë që i turren këtij profesioni, do të kenë mbi vete detyrimet ligjore, çka do të ndikojë për ta sjellë shtypin në parametra normalë.

2. Kërkesa, që kryeredaktori të jetë anëtar i Urdhrit të Gazetarit (Neni 7/ a), meqë siç do të shprehem më poshtë, ky kre është tepër i diskutueshëm, më duket si një lloj diktati që s’mund të ketë vend në një ligj demokratik.

3. Kreu II (E drejta për informim) lë ende pezull disa pikëpyetje. Ato burojnë nga vetë natyra e kësaj të drejte, që përbën një nga mbështetjet kryesore për pushtetin e katërt. Nëse nuk do të përcaktohen rregulla të qarta për të drejtën e informimit, atëherë çdokush që është i interesuar ta fshehë ose ta manipulojë informacionin, do të gjejë brenda vetë ligjit shumë shtigje për të shpëtuar pa u lagur. Janë disa nene të lëna hapur për ekuivoke që e krijojnë këtë përshtypje. Te “Parimi i mosdiskriminimit” (Neni 15), ndonëse ndalohet privilegji dhe diskriminimi nga ana e autoritetit publik, nuk jepet

asnjë referencë nga Kodi Civil për përgjegjësitë që rrjedhin nga ky veprim. Te neni 16 (“Mbrotjtja e burimit të informacionit”, pika 4/b në të dy variantet, le hapësirë për interpretime subjektive nga autoritetet gjyqësore, gjë që mund t’i sjellë pasoja të rënda burimit të informacionit (individë ose grupe), çka është krejt e pritshme në një klimë të ndezur të krimit të gjakmarrjes si e jona. Nuk përcaktohet, gjithashtu, asnjë sanksion për rastin e kundërt, domethënë kur burimi është përdorur padrejtësisht.

Kreu më i diskutueshëm është ai për “Urdhrin e gazetarit”. Debati këtu prek thelbin: Duhet apo s’duhet ky urdhër? Dihet se ka një “Urdhër të Mjekut”, por këtu analogjia nuk ndihmon shumë, sepse mjeku si profesionist ka bërë betimin e Hipokratit, që e detyron ndër të tjera të japë ndihmën e tij sa herë i kërkohet. Në mjekësi interpretimi i faktit është strikt dhe subjektivizmi ose gabimi kanë pasoja të drejpërdrejta për jetën, që do të thotë se edhe përgjegjësia është e tillë. Në këtë rast, shteti, s’mund të rrijë indiferent. Një “Urdhër Gazetari” siç jepet në projekt, mund të krijojë paralelizmin me një shoqatë të komanduar nga shteti, ku aderimi bëhet për forcë a detyrim profesioni, kurse përjashtimi e ndëshkimi “shtetërisht”. Nuk di nga është vjelë kjo përvojë, por në kushtet tona kur shteti me fijen e tij ka dorë të përpunojë shumë opinione dhe ta përdorë ose ta mjelë median në mënyra të ndryshme, ky Urdhër ka rrezik të kthehet në të kundërtën e qëllimit, pra në një lloj censori të ligjëruar, që vepron në prapaskenë kundër kujtdo që i duket “rebel”!

Nëse duhet një mekanizëm për të rregulluar raportet midis profesionistëve të gazetarisë, këtë le ta vendosin ata vetë në marrëveshje midis shoqatave dhe pa cenuar lirinë e kurrkujt, madje edhe në ato raste kur, pa shkelur ligjet, gazetari shfaqet kryeneç, i pabindur ose “kryengritës”. Një demaskim i përligjur nga kolegët, kur gazetari shkel Kodin Etik, ka peshë më të rëndë sesa pezullimet ose çregjistrimet nga “Urdhri”.

Një ligj për shtypin apo kundër shtypit? Debat mbi projektligjin "Akti i Lirisë së Shtypit"

Nga Alban Bala

Korrespondent i radios "Europa e Lirë"

Marrëdhëniet e shtetit shqiptar me shtypin, të paktën në dhjetë vitet e fundit, asnjëherë nuk kanë qenë idilike, por kanë ardhur gjithnjë duke u ashpërsuar. Kjo perspektivë duket se do të bëhet më e ndjeshme nëse Kuvendi do të miratojë një projektligj të ri, të mbiquajtur Akti i Lirisë së Shtypit.

Sipërmarrja e Kuvendit, për t'i garantuar shtypit sa më parë lirinë e shprehjes dhe një mbrojtje juridike, është një hap që duhet përgëzuar. Por shtypi ka sot nevojë më shumë se për paprekshmëri. Atij i duhet një kuadër ligjor, i cili t'i kthejë dinjitetin e humbur nëpër betejat politike.

Duhet pranuar se ashtu si çdo aspekt tjetër i jetës shqiptare, shtypi po përjeton krizën e tij më të thellë, një krizë që buron pikë së pari nga misioni politik që ai i ka ngarkuar vetes, në emër të mbijetesës ekonomike dhe të pragmatizmit të botuesve. Kjo krizë shfaqet jo vetëm përmes shkretëtirës së ideve, por kryekrejtë përmes sipërmarrjeve ekstramediatike ose, thënë më troç, përmes zhvendosjes së qëllimit të pushtetit të katërt në kolonë të pestë të tri pushteteve të tjera. Për këtë arsye unë mendoj se një ligj për shtypin është më i brishtë se, të themi, një ligj për policinë ose për mbledhjen taksave, dy instrumente që mbajnë në këmbë vetë shtetin.

Shtypi ka arritur, që mes një beteje shumë të ashpër, si gjatë viteve 1992-1997 e sidomos gjatë katër viteve të fundit, ta fitojë lirinë e tij. Tani ai nuk ka më tema tabu, nuk ekzistojnë çështjet dhe individët e paprekshëm dhe

kjo pikë mbetet meritë e shtypit dhe e guximit të njerëzve të tij, veçmas e atyre pranë opozitës.

Por për të blerë lirinë e humbur, në një shoqëri paskomuniste, shtypi është detyruar ta tejkalojë të drejtën e tij. Me një fjalë, shtypi shqiptar i ka blerë shumë shtrenjtë fitoret e tij. Ai ka nxitur në vend një polarizim të skajshëm politik dhe ka institucionalizuar një zhargon epitetesh, i cili nuk njihej më parë në të folmen e gjerë qytetare. Për faj të gjuhës së shterrur që gazetaret (nuk) njohin, publiku është sot para shtrëngesës, që të komunikojë me 200 fjalët më të domosdoshme, ku mugojnë jo vetëm sinonimet dhe cilësorët, por vetë konceptet.

Duke humbur misionin, shtypi ka humbur aktualisht edhe objektin e punës së tij. Lajmet që përcillen në media shumë rrallë kanë vlera informative, ndërsa gazetatat, falë ndikimit njëzënor politik dhe cektësisë profesionale, edhe pse të ndara në kampe, janë kthyer në gjedhe monotone të njëra-tjetrës.

Për këtë shkak, ndjeshmëria publike në vend është sot më e ulëta e dhjetë viteve të fundit. Në tregun e gazetave, tirazhin e zbehtë të shitjeve ende e përcakton çmimi. Ky proces është shoqëruar me një zbatice të patregueshme etiko-morale në një rrafsh mbarëshoqëror.

Në një studim për median të kryer nga Qendra Shqiptare e Kërkimeve Ekonomike, analisti Preç Zogaj shprehet pa asnjë fije humori se “gazetat sportive mbesin të vetmet që nuk e shtrembërojnë të vërtetën e lajmeve të tyre”. Ky tregues është tragjik për një shoqëri, e cila kërkon të strukturojë instrumente jetëgjata për një vetërregullim të brendshëm të funksioneve.

Përvojat ligjore në marrëdhëniet e shtypit me shtetin deri tani kanë qenë të dështuara. Ky precedent i jep këtij *momentum-i* ligjbërës më shumë peshë. Një ligj për shtypin, i mbiqajtur “modeli i Westfalisë”, u zhbë pasi synonte vendosjen e shtypit nën një kontroll formal, gjë që shkonte ndesh me frymën e zhvillimeve të fundit europiane. Dështimi i ligjit të parë për shtypin buroi nga pavarësia e pamundur e gjykatave, në një vend ku mungonte tradita e demokracisë perëndimore.

Në këmbë të tij, Kuvendi pasardhës vendosi të bënte një show: ai miratoi një ligj-tip lojë-fjalësh, me dy nene, për shtypin, ku sanksionohet se shtypi është i lirë dhe se liria e shtypit mbrohet me ligj. Por kësaj here politika çoi në gjykatë mbi 50 gazetarë, tërësisht prej shtypit të opozitës, dhe një numër i konsiderueshëm prej tyre morën edhe penalizime. Të paktën pesë prej tyre janë ende të angazhuar në procese gjykimi që vazhdojnë. Për këtë shkak një ligj, i cili kërkon ngritjen e një Urdhri të Gazetarëve, ishte si një muzikë për veshët e mi. Përpara se projektligji të bëhej gati, Halil Lalaj më tha në një intervistë për radion “Europa e Lirë” se ky ligj do të ndërpriste praktikën e dërgimit të gazetarëve në Gjykatë. Por Akti i Lirisë së Shtypit është shumë më zhgënjyes se një premtim i tillë vagullor. Në pjesën e parë, ai nuk i shton shumë praktikës së përkufizuar deri tani në legjislationin në fuqi, si në Kodin e Procedurës Penale, ashtu edhe në atë Civile. “Akti...” është, megjithatë, më i detajuar dhe kjo shënon një anë pozitive të tij. Por çfarë është Urdhri i Gazetarëve, kush e drejton atë dhe kujt i shërben ai? Këto elemente gjejnë në “Aktin e Lirisë së Shtypit” shtrembërimin flagrant të konceptit të Lirisë së Shtypit, si dhe një mbrojtje të fuqishme të gjendjes aktuale të tij.

Problemi kryesor i projektligjit është ligjësimi që ai i bën varësisë së Urdhrit të Gazetarit nga Komisioni Parlamentar i Mjeteve të Informimit Publik.

Neni 35 pika 2 i “Aktit..” përcakton shprehimisht se “në muajin tetor të çdo viti kalendarik, Këshilli Kombëtar i Urdhrit i paraqet Komisionit Parlamentar të Mjeteve të Informimit Publik raportin e veprimtarisë së tij njëvjeçare, i cili shqyrtohet në një mbledhje të veçantë të Komisionit”. Cila është arsyeja që përfaqësuesit më të lartë të atyre që mbikëqyrin politikën dhe jetën e vendit të paraqiten për raportim përpara një komisioni parlamentar, të kontrolluar dhe drejtuar politikisht? Pse edhe për gazetarët caktohet e njëjta praktikë që zbatohet, të themi për Avokatin e Popullit, i cili në fund të fundit zgjidhet nga parlamenti dhe për një marrëveshje fjalësh quhet “i pavarur”?

Shpjegimi vjen më poshtë, brenda projektligjit, po kaq i qartë sa emri i tij: edhe Urdhri i Gazetarit do të zgjidhet nga një komision politik i parlamentit, për të qenë më pas “i pavarur”. Në qoftë se projektligji do të kërkonte që Urdhri të hartonte një raport vjetor dhe këtë për dijeni t’ia përcillte publikut, Presidentit, Kryeministrit, Kuvendit, KE-së, BE-së, OSBE-së etj., asgjë e keqe nuk do të jehonte prej kësaj. Por neni 64, pika 1 dhe 2 përcakton se “Komisioni i Mjeteve të Informimit Publik në Kuvendin e Shqipërisë, mbi bazën e propozimeve nga shoqatat, organizatat profesionale ose grupet e gazetarëve dhe në bashkëpunim të ngushtë me to, brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, miraton Këshillin e Përkohshëm Kombëtar të Urdhrit...Këshilli i Përkohshëm Kombëtar i Urdhrit, i cili ushtron funksionet e tij përgjatë një viti nga momenti i krijimit, përbëhet nga 7 anëtarë dhe është i ngarkuar me detyrën e organizimit të mbledhjes formuese të Urdhrit”. Pra, Urdhri fillestar të Gazetarit e themelon Kuvendi, i cili ka një shumicë politike dhe një interes të skajshëm për ta neutralizuar shtypin.

Neni 64/6, i cili ia përjashton megjithatë atributet ekzekutive Këshillit të Përkohshëm, sqaron se brenda 30 ditëve nga formimi, ky Këshill ka për detyrë të nisë hartimin e Regjistrimit të Gazetarëve, një tjetër “libër magjie”, që bie era politike. Sipas ligjit, në Regjistrin e Gazetarëve shënohen ata gazetarë profesionistë, që “kanë vendosur marrëdhënie të rregullta pune me organin ku punojnë, kanë nënshkruar një kontratë pune për më shumë se 12 muaj dhe plotësojnë kriteret profesionale të përcaktuara nga Urdhëri” (neni 36, pika 2).

Kriteret profesionale përfshijnë arsimin e lartë, ku nuk përjashtohet asnjë degë e tij (neni 37/1).

Kriteret juridike kërkojnë që anëtarë i Urdhrit të mos jetë ndjekur penalisht, të paktën tre vjet përpara datës së regjistrimit në Urdhër (neni 37/2). Ky kusht përjashton automatikisht nga e drejta e anëtarësimit një numër gazetarësh të opozitës, të cilët janë përballur me gjykime civile tepër të diskutueshme.

Shtypi duhet të jetë i pari që duhet ta marrë seriozisht lajmin se niveli më i lartë i korrupsionit në vend gjallon në organet e drejtësisë. Mjafton të kujtohet rasti i Shemsi Peposhit, i cili u dënua nga Gjykata e Faktit në Tiranë me rreth 600 mijë lekë gjobë, vetëm pse i kërkoi znj. Monika Kryemadhi, të sqaronte akuzat që iu bënë asaj publikisht nga opozita.

Nëse “Akti..” miratohet me një kushtëzim të tillë përjashtues, i gjithë procesi i formimit të Urdhrit, i cili në vetvete shënon një hap para, do të kompromentohej rëndë dhe do të kthehej në një bumerang të rrezikshëm, duke prishur përfundimish ekuilibrat e politikës në rrafshin e komunikimit masiv.

Në nenin 46 pika 2, projektligji i garanton një leje ligjore ndërhyrjes politike në jetën e shtypit. Kjo pikë saktëson se “Në rastet kur numri i anëtarëve të Këshillit Kombëtar zbret nën numrin ligjor të tij apo kur Këshilli nuk e siguron kuorumin e nevojshëm për të paktën tre mbledhje të njëpasnjëshme në një afat dymujor, ose kur Këshilli nuk mund të sigurojë shumicën vendimmarrëse për të paktën tri mbledhje të njëpasnjëshme në një afat dymujor, atëherë Komisioni i Përhershëm i Mjeteve të Informimit Publik organizon thirrjen e mbledhjes së përgjithshme të Urdhrit, me qëllim zëvendësimet ose organizimin e zgjedhjeve të reja në Këshill”. Kjo do të thotë se për çfarëdo arsye politike, për veprim ose mosveprim të Këshillit të Përgjithshëm të Urdhrit në kundërshtim me vijën politike të shumicës së Komisionit të Përhershëm të Mjeteve të Informimit Publik, shumica parlamentare mund të provokojë ribërjen e kryesisë së Urdhrit në përputhje me interesat e saj. Varësia e Urdhrit të Gazetarëve nga shumicat parlamentare me këtë nen është e sanksionuar. Për këtë arsye, unë mendoj se detyra e Komisionit të Përhershëm Parlamentar të Medias mbaron me përpilimin e këtij projektligji dhe me ndryshimin e tij në favor të pavarësisë së shtypit si institucion në tërësi dhe si njësi editoriale në veçanti. Më duhet të pohoj se në ligj mbisundon një prikje e kundërt me këtë.

Urdhri i Gazetarit në tërësi është konceptuar i pavarur nga botuesit e shtypit, por jo i pavarur nga politika. Këshilli Kombëtar, i cili siç thamë më

lart mund të kontrollohet nga shumica politike e vendit si organ vendimor, gëzon në çdo kohë të drejtën e shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv, i cili kryeson Komisionin Disiplinor. Kjo i paragjykon thelbësisht të gjitha masat disiplinore që mund të vendosë Urdhri, duke ia humbur atij vetë, me ligj, besueshmërinë.

Urdhri i Gazetarit ka fuqi ekzekutive dhe kjo është një gjë e mirë. Siç është parashkruar, ai supozohet se e mbron gazetarin nga keqtrajtimi profesional dhe financiar, ai e mbron atë ligjërisht dhe përçon në publik një klimë pajtimi mes audiencave të ndryshme, sot për sot të organizuara mbi baza politike.

Një ndër pikat e rëndësishme të këtij projektligji ka të bëjë me rrugët e financimit të veprimtarisë së Urdhrit. Pika 2 e nenit 40, lidhur me “Burimet financiare të Urdhrit”, saktëson se ai mund të subvencionohet edhe nga buxheti i shtetit.

Kjo pikë është më mirë të mos jetë, ndërsa me krijimin e Urdhrit, shteti mund t’i dhurojë atij një mjedis për zhvillimin e veprimtarisë, si dhe një bazë logjistike, pa pasur nevojë ta parashkruajë këtë në ligj. Ndikimi i këtyre subvencioneve është i dyfishtë, pasi ai mund të prishë ballancën politike të drejtimit të Urdhrit. Po ashtu, kjo i jep hapësirë Kontrollit të Shtetit t’i bëjë presion Urdhrit përmes së drejtës që ai ka sipas nenit 42/3 për të kontrolluar mënyrën e administrimit të këtyre subvencioneve. Kjo do të kompromentonte marrëdhëniet e Urdhrit me instancat shtetërore nga njëra anë dhe me gazetat kritike ndaj qeverisë, nga ana tjetër.

“Akti..” saktëson në nenin 55/2 se ai “synon krijimin e një praktike unike në trajtimin e shkeljeve të mundshme të këtyre normave”. Kjo gjë nënkupton se Urdhri do ta ngrejë gjykimin etik të shtypit mbi bazën e precedentit. Por si do të sillet Urdhri deri në krijimin e një precedenti fillestar? Kjo pyetje mbetet pa përgjigje dhe ndoshta ajo flen në sirtaret e Komisionit të Përhershëm të Mjeteve të Informimit Publik.

Në mbyllje, më duhet të pranoj se projektligji i “Aktit të Lirisë së Shtypit” nuk vuan nga probleme të formulimit, por ai mbart të meta serioze në

mënyrën sesi është konceptuar. Në qoftë se organi suprem i shtypit do të jetë një komision parlamentar i kontrolluar nga politika korrente, shtypi shqiptar do të jetë përgjithnjë një shërbëtor i keq i atyre që kërkojnë që në Shqipëri të mos ketë asnjëherë një opinion publik kritik dhe aktiv, gjykues dhe të informuar. Dhe kjo është humbja më e madhe për vendin, i cili ka nevojë urgjente të zhvillojë mekanizma të brendshëm vetërregullues, mekanizma moralë dhe autoritete të besueshme qytetare, që t'i japin legjitimitet pushtetit politik, i cili e ka humbur besueshmërinë dhe etikën.

Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend

Kjo rubrikë synon dhënien e një informacioni mbi legjislacionin e miratuar rishtazi, duke patur parasysh se njohja fillestare e legjislacionit përbën një nga elementet vitale të një shoqërie demokratike. Lidhja midis qytetarëve dhe qeverisë së tyre është e fortë vetëm atëhere kur shqetësimet e tyre, pra, të publikut pasqyrohen në legjislacionin përkatës. Qytetarët që e konsiderojnë qeverinë e tyre si legjitime, ka më shumë të ngjarë që t'i binden edhe ligjeve të saj. Në të njëjtën kohë, synohet t'i vihet në ndihmë subjekteve publike dhe private që “konsumojnë” ligje për një kuptim të shpejtë dhe objektiv të legjislacionit të miratuara rishtazi në Kuvend.

1. Ligj nr. 8691, datë 16.11.2000 “ Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë prodhimin, tregtimin e duhanit të papërpunuar, përpunimin industrial, tregtimin e duhanit të përpunuar dhe të produkteve të tij ne Republikën e Shqipërisë. Për mbikëqyrjen dhe kontrollin e prodhimit dhe të tregtimit të duhanit dhe të produkteve të tij, ligji ngarkon Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit. Persa i përket kontrollit fiskal, kjo realizohet nga Ministria e Financave në përputhje me legjislacionin ne fuqi. Prodhuesit e duhanit, sipas ligjit, prodhojnë gjethe duhani për treg, mbi bazën e kontratës së shkruar të prodhimit, me persona juridikë e fizikë, vendas dhe të huaj, të regjistruar si grumbullues e përpunues industrialë të duhanit në regjistrat e strukturave të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit në rrethe. Këto subjekte pajisen me leje grumbullimi nga Ministria e

Bujqësisë dhe Ushqimit. Prodhuesit e duhanit janë të detyruar që çdo fillim viti, brenda 31 majit, të bëjnë deklaratë me shkrim, në strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit në rreth, me të dhënat faktike për vendin e prodhimit, sipërfaqen, tipin, llojin dhe prodhimin e pritshëm të duhanit. Pranë këtyre strukturave duhet të mbahet regjistri i prodhuesve të duhanit dhe i sipërfaqeve të kultivuara me duhan. Prodhuesit dhe importuesit e produkteve të duhanit duhet të regjistrojnë markat e tyre në Regjistrin e Markave pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit. Produktet e duhanit, të prodhuesve të vendit ose të importit, të pranishme në tregun shqiptar, duhet të tregtohen vetëm me pullë fiskale, të ngjitur në ambalazhin përdorues, nën letrën e tejdukshme të paketës. Për nxitjen, zhvillimin dhe garancinë e prodhimit, të përpunimit dhe të tregtimit të duhanit dhe të produkteve të tij, ligji krijon Agjencinë Kombëtare të Duhan-Cigareve, me statusin e personit juridik, pa qëllim fitimi. Ligji parashikon kundërvajtje administrative për shkelje të vecanta të ligjit, të cilat dënohen me gjobë. Gjoba mund të jetë nga 20 mijë lekë deri në një milion lekë dhe mund të shoqërohet me sekuestrim. Dënimet dhe masat administrative vendosen nga organet përkatëse të Ministrisë së Financave dhe nga inspektorët e Agjencisë Kombëtare të Duhan-Cigareve pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

Ky ligj ka 26 nene dhe ka hyrë në fuqi më 18.01.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.45, 2000, faqe 1991.

2. Ligj nr. 8693, datë 23.11. 2000 “Për ratifikimin e “Amendamentit të Konventës Financiare ndërmjet qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale- Itali për financimin e përbërësve të asistencës teknike për ndërmarrjen e ujërave dhe të ndërhyrjeve infrastrukturore në rrjetin hidrik, në kuadër të projektit të rehabilitimit të rrjetit hidrik të Tiranës”

Amendamenti nr.1 bën dy ndryshime në Konventën Financiare ndërmjet qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale- Itali për

financimin e përbërësve të asistencës teknike për ndërmarrjen e ujërave dhe të ndërhyrjeve infrastrukturore në rrjetin hidrik, në kuadër të projektit të rehabilitimit të rrjetit hidrik të Tiranës. Konventa është firmosur në 11 maj 2000. Ndryshimet që behen nëpërmjet këtij Amendamenti konsistojnë në:

- Kontratat në lidhje me projektin që parashikon pika 1.2 e Konventës do të trajtohen sipas procedurave të përzgjedhjes së Bankës Botërore për prokurorimin e shërbimeve, të punimeve dhe mallrave, duke mbajtur parasysh specifikën e kredisë italiane.
- Përqindja e “përrjashtimit” e pranuar për secilën nga kontratat e pikës më sipër, fiksohen në maksimumin 35% të vlerës së kontratës.

Ky ligj ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 29.12.2000. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.40, 2000, faqe 1902.

3.Ligj nr. 8694, datë 23.11.2000 “Për ratifikimin e marrëveshjes për konsolidimin e borxhit të jashtëm të Shqipërisë, në bazë të termave të referencës së Klubit të Parisit, të 22 korrikut 1998, ndërmjet qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Italiane”

Marrëveshja për konsolidimin e borxhit të jashtëm të Shqipërisë, në bazë të termave të referencës së Klubit të Parisit, të 22 korrikut 1998, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane, ratifikuar me ligjin nr.8694 ka për objekt reduktimin dhe riorganizimin e borxhit të Republikës së Shqipërisë. Përfaqësuesit e Qeverive të Vendeve Kreditore pjesëmarrëse, vënë në dukje nëpërmjet kesaj Marrëveshje, masat e forta ekonomike dhe financiare në programin e rimëkëmbjes të ndërmarrë nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe të mbështetura nga ESAF, e aprovuar nga Bordi Ekzekutiv i FMN në 13 maj 1998. Theksohet rëndësia që ka zbatimi i plotë dhe i vazhduar i këtij programi dhe në vecanti rivitalizimi i sektorit prodhues të ekonomisë dhe përmirësimi i financave publike dhe menaxhimit të këmbimit valutor. Borxhet për të cilat bëhet riorganizimi janë si më poshtë:

- a) kreditë komerciale të garantuara ose të siguruara nga qeveritë e vendeve kreditore pjesëmarrëse ose institucioneve të tyre përkatëse, duke pasur maturitet fillestar më shumë se 1 vit dhe që i janë dhënë Qeverisë së RSH ose institucioneve të saj përkatëse, ne bazë të një marrëveshje të përfunduar para 30 shtatorit;
- b) hua nga qeveritë ose institucionet përkatëse të vendeve kreditore duke pasur maturitet më shumë se 1 vit dhe që i janë dhënë Qeverisë së RSH ose institucioneve të saj, ose janë mbuluar nga garancia e RSH ose institucioneve të saj përkatëse, në bazë të një marrëveshjeje që është përfunduar përpara 30 shtatorit.

Me qëllim që të sigurojë trajtim të krahasueshëm të borxhit ndaj gjithë kreditorëve privatë ose publikë, Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në bazë të marrëveshjes, vetangazhohet të negociojë menjëherë për rregullimet mbi uljen e borxhit me gjithë kreditorët e jashtëm.

Ky ligj ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 29.12.2000. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.40, 2000, faqe 1903.

4. Ligj nr. 8695, datë 23.11.2000 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes për konsolidimin e borxhit të jashtëm të Shqipërisë, në bazë të termave të referencës së Klubit të Parisit, të tetorit 1999, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane”

Objekt i kësaj marrëveshje është shtyrja e disa borxheve, për kapitale e interesa, me skadencia dhe afate të ndryshme të përcaktuara në nenin 1 të marrëveshjes. Borxhet e përmendura në nenin 1 të marrëveshjes do të rimbursohen dhe kthehen në valutën e përcaktuar në kontratë ose në marrëveshjet financiare përkatëse nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë tek SACE dhe Mediocredito Centrale mesatarisht në 10 këste gjashtë mujore, të barabarta dhe të njëpasnjëshme, me skadencë të parë në 30 qershor 2001 dhe e fundit në 31 dhjetor 2005.

Ky ligj ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 31.12.2000. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.41, 2000, faqe 1863.

5. Ligj nr. 8696, datë 23.11.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Vjenës “Për të drejtën e traktateve”

Nëpërmjet aderimit në Konventa e Vjenës “Për të drejtën e traktateve”, Republika e Shqipërisë merr përsipër të zbatojë detyrimet dhe parashikimet e kësaj Konvente lidhur me traktatet me shtete të tjera. Në kuptimin e konventës me “traktat” kuptohet një marrëveshje ndërkombëtare, i përfunduar midis shteteve në formë shkresore dhe udhëhequr nga e drejta ndërkombëtare, i cili, pavarësisht nga emërtimi i tij i vecantë, është i materializuar në një dokument të vetëm apo dy ose më shumë dokumente që lidhen me njëri-tjetrin. Konventa parashikon rregulla lidhur me përfundimin dhe hyrjen në fuqi të traktateve si dhe kur një person konsiderohet si përfaqësues i një shteti, miratimin e tekstit të traktatit, etj. Në një seksion të vecantë Konventa parashikon mënyrën e bërjes së rezervave si dhe pranimin e kundërshtimit të rezervave. Në pjesën e tretë të Konventës parashikohen rregulla lidhur me respektimin, zbatimin dhe interpretimin e traktateve. Në vazhdim parashikohen rregulla për amendamentet dhe modifikimet e traktateve. Në pjesën e fundit të Konventës parashikohen rregulla lidhur me pavlefshmërinë, përfundimin dhe pezullimin e veprimit të Traktatit.

Ky ligj ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 29.12.2000. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.40, 2000, faqe 1913.

6. Ligj nr. 8697, datë 23.11.2000 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së huasë ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë Greke për projektin e infrastrukturës sociale për sektorin e arsimit”

Marrëveshja e huasë ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë Greke për projektin e infrastrukturës sociale për sektorin e arsimit, ratifikuar me ligjin 8697, ka për objekt dhënien e një huaje deri në 1 500 000 000 GRD nga huadhënësi (pala greke) për projektin e rindërtimit të shkollave egzistuese dhe ndërtimin e shkollave të reja sipas një liste të miratuar nga huadhënësi. Huamarrësi (pala shqiptare), sipas marrëveshjes

merr përsipër të kontribuojë me sigurimin e tokës që kërkohet për ndërtimin e shkollave të reja. Gjithashtu, huamarrësi merr përsipër të mbulojë të gjitha shpenzimet në lidhje me të gjitha studimet, projektet e nevojshme dhe infrastrukturën. Norma e interesit të aplikueshëm për këtë hua do të jetë 5% në vit. Huamarrësi duhet të kthejë huanë e plotë në 37 këste gjysmë-vjetore. Në Marrëveshjen e Huasë parashikohen gjithashtu, rregulla që lidhen me përfaqësimin dhe garancitë, kushtet për disbursimin, rastet e mospagesave si dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Palët kanë rënë dakord që Gjykatat e Republikës Greke do të kenë juridiksionin për të dëgjuar dhe vendosur cdo padi dhe konflikt.

Ky ligj ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 28.11.2000. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.43, 2000, faqe 1936.

7. Ligj nr. 8698, datë 23.11.2000 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë Greke për projektin e infrastrukturës sociale për sektorin e shëndetësisë”

Nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje, huadhënësi (pala greke) pranon t’i japë një hua palës shqiptare deri 1 500 000 000 GRD për t’u përdorur ekskluzivisht për blerjen e pajisjeve të Maternitetit të Ri të Tiranës, i cili është pjesë përbërëse e spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik. Huamarrësi (pala shqiptare) merr përsipër të mbulojë të gjitha shpenzimet që i referohen transferimit dhe instalimit të pajisjeve. Norma e interesit të aplikueshëm për këtë hua do të jetë 5% në vit. Huamarrësi duhet të kthejë huanë e plotë në 37 këste gjashtë-mujore. Në Marrëveshjen e Huasë parashikohen gjithashtu, rregulla që lidhen me përfaqësimin dhe garancitë, kushtet për disbursimin, rastet e mospagesave si dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Palët kanë rënë dakord që Gjykatat e Republikës Greke do të kenë juridiksionin për të dëgjuar dhe vendosur cdo padi dhe konflikt.

Ky ligj ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 28.11.2000. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.43, 2000, faqe 1949.

8. Ligj nr. 8699, datë 23.11.2000 “Për ratifikimin e Konventës-Kuadër Evropiane “Për bashkëpunimin ndërkufitar të bashkësive vendore e të autoriteteve territoriale dhe të dy protokolleve shtesë të saj”.

Konventa-Kuadër Evropiane “Për bashkëpunimin ndërkufitar të bashkësive vendore e të autoriteteve territoriale dhe të dy protokolleve shtesë të saj” ratifikuar me ligjin 8699 ka si objekt nxitjen e bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet bashkësive ose autoriteteve territoriale që janë nën juridiksionin e saj dhe bashkësive ose autoriteteve territoriale që janë në kompetencë të palëve të tjera kontraktuese. Në kuadrin e Konventës konsiderohet si bashkëpunim ndërkufitar cdo mirëkuptim që synon të forcojë e të zhvillojë fqinjësinë ndërmjet bashkësive ose autoriteteve territoriale që varen nga dy ose shumë palë kontraktuese, si dhe lidhja e marrëveshjeve dhe bashkëpunimet e nevojshme për këtë qëllim. Shtetet palë të Konventës duhet të favorizojnë nismat e bashkësive dhe autoriteteve territoriale. Gjithashtu, në rastin e një bashkëpunimi ndërkufitar sipas kësaj Konvente, shteti që është palë do të shikojë mundësinë për t’i akorduar bashkësive ose autoriteteve territoriale pjesëmarrëse të njejtat lehtësi si në rastin kur bashkëpunimi do të ushtrohet në planin e brendshëm. Shteti palë në Konventë duhet të japë sa të jetë e mundur informacionet që i kërkohen nga një palë tjetër kontraktuese, me qëllim që të lehtësojë vënien në zbatim të detyrimeve të Konventës.

Ky ligj ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 31.12.2000. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.41, 2000, faqe 1873.

9. Ligj nr. 8700, datë 23.11.2000 “Për anëtarësimin e Laboratorit të Testimit të Farave dhe Fidanëve në shoqatën ndërkombëtare të Testimit të Farave (ISTA)”

Ligji nr.8700 ka për objekt anëtarësimin e Laboratorit Kombëtar të Testimit të Farave dhe Fidanëve pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit në Shoqatën Ndërkombëtare të Testimit të Farave (ISTA), si autoritet i emëruar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Objekti parësor

i ISTA është të zhvillojë, miratojë dhe të bëjë procedurat standarde për kampionizimin dhe testimin e farërave dhe të nxisë zbatimin njëloj të këtyre procedurave për vlerësimin e farërave që shkëmbehen në rrugë tregëtare. Gjithashtu, kjo organizatë synon nxitjen aktive për kërkime shkencore në të gjitha fushat që lidhen shkencën dhe teknologjinë e farërave. Cdo anëtar në ISTA duhet të paguajë një kuotizacion vjetor. ISTA organizohet sipas statutit ku cdo anëtar përfaqësohet dhe merr pjese në marrjen e vendimeve.

Ky ligj ka 3 nene dhe ka hyrë në fuqi më 31.12.2000. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.42, 2000, faqe 1915.

Iniciativa ligjvënëse e deputetëve: Instrument real apo formal?

Haxhi Aliko
Deputet

Neni 81, paragrafi i parë i Kushtetutes së Republikës të Shqipërisë përcakton: “ Të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet si dhe 20 mijë zgjedhës”. Mbi bazën e kësaj të drejte kushtetuese është hartuar edhe neni 125 i Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, i cili është mbartur pa asnjë ndryshim nga Kushtetuta. Madje e drejta e iniciativës ligjvënëse e deputetëve është e garantuar edhe nga Dispozitat Kushtetuese të vitit 1991.

Pra, ka plot 9 vjet që deputetët e Kuvendit të Shqipërisë gëzojnë këtë të drejtë ligjvënëse, por është shumë e dyshimtë në se gjatë këtyre 9 vjetëve të veprimtarisë së Kuvendit demokratik, të jenë propozuar 9 projektligje nga vetë deputetët. Statistikat tregojnë se që nga 5 korriku i vitit 1991, kur është miratuar ligji i parë nga Kuvendi i parë pluralist i Shqipërisë dhe deri sot, janë miratuar 1146 akte ligjore, ku pothuajse të gjithë janë propozuar nga Këshilli i Ministrave apo nga Presidenti. Kaq do të mjaftonte që pyetjes së shtruar, që në titullin e këtij referati, t’i jepet një përgjigje e prerë: kjo e drejtë e iniciativës ligjvënëse të deputetëve, ka mbetur një instrument formal. Kështu do të shprehej një njeri skeptik, kurse unë nuk i përkas kësaj kategorie, prandaj do të përpiqem të argumentoj se një përgjigje e tillë nuk mund të përlligjej plotësisht dhe për pasojë nuk mund të pranohej pa komente. Jam i bindur se ka një sërë shkaqesh të rëndësishme, që kanë ndikuar fuqishëm në mosshfrytëzimin e kësaj të drejte nga ana e deputetëve. Do të përpiqem të rendis e të komentoj disa prej këtyre shkaqeve, të cilat i vlerësoj si më të rëndësishmet dhe me ndikim më të fuqishëm në këtë dukuri.

Parlamenti shqiptar i dalë nga zgjedhjet pluraliste, si hapi i parë i madh i vendosjes së demokracisë në Shqipëri, vihej përballë detyrës madhore për krijimin *ex novo* të të gjithë legjislacionit, për një sistem të ri politik, ekonomik dhe social, i cili duhej të ngrihej mbi gërmadhën që la prapa diktatura komuniste e përmbysur. Lipsej kështu, një veprimtari ligjvënës e gjithanshme dhe tepër intensive, e cila do të kërkonte angazhimin e gjatë të Kuvendit, në disa legjislatura. Hartimi i shumë ligjeve themelore: Kushtetuta, kuadri ligjor për pushtetin gjyqësor, për sistemin financiar dhe fiskal, për pronën private dhe pronësinë dhe shumë e shumë të tjera, kërkonin detyrimisht vullnet politik maksimal, predispozim për konsensus politik dhe në mënyrë të pashmangshme edhe përvojë e kompetencë politike, juridike dhe ekonomike, të cilat vështirë se mund të gjëndeshin në masën e mjaftueshme në shoqërinë shqiptare pas diktaturës. Asistenca e kualifikuar e vendeve demokratike euroatlantike ishte e domosdoshme dhe ajo iu ofrua Shqipërisë në mënyrë tepër gjeroze nga komuniteti ndërkombëtar. Në këto kushte, ishte gati e pamundur që të gjente vend iniciativa ligjvënës e deputetëve të rinj shqiptarë dhe, për këtë arsye plotësisht të përligjur, nuk ka pse të shprehim keqardhje.

Jo më pak ndikim në frenimin e iniciativës ligjvënës të deputetëve ka pasur dhe atmosfera e hiperpolitizuar konstante gjatë gjithë periudhës së tranzicionit në Shqipëri. Për shkaqe të mirënjohura e të kuptueshme prej të gjithëve, të katër Kuvendet që kanë dalë nga zgjedhjet politike pluraliste, kanë pasur të njëjtën karakteristikë themelore: dominimin e ekzagjeruar të njëjës parti politike – mbi 60%. Vazhdimisht, gjatë 9 vjetëve, opozita ka qenë tepër modeste numerikisht në Kuvend. Në këto kushte, shumica parlamentare identifikohet spontanisht me ekzekutivin dhe çdo iniciativë ligjvënës, nga Qeveria, nga grupi i deputetëve ose nga deputetë të veçantë, automatikisht identifikohet dhe integrohet si vullnet i shumicës, të partisë së tyre. Deputeti shqiptar vazhdon ta konsiderojë veten shumë më tepër si përfaqësues dhe militant të partisë së tij sesa i zgjedhësve. Një psikozë e tillë e përgjithshme e bën krejt të pavlefshëm faktin që ai, deputeti, ka të

drejtë, madje dhe për detyrë, për të iniciuar veprime ligjvënëse. Edhe kur ka ndodhur në Kuvend të paraqiten projektligje nga një grup deputetësh (këto raste janë tepër të pakta), gjithnjë ato kanë qenë të nxitura nga Qeveria ose nga hallka të tjera të shtetit për të përshpejtuar miratimin e tyre. Po ashtu, ka ndodhur (gjithnjë mjaft rrallë), për të njëjtat arsye psikologjike, që iniciativat ligjvënëse reale të deputetëve të ndryshojnë vullnetarisht autorësi dhe të paraqiten nga ekzekutivi.

Përvoja e gjatë politike dhe veçanërisht ajo demokratike janë faktorë të një rëndësie madhore që ndikojnë fuqishëm në funksionimin normal dhe efektiv të Parlamentit. Demokracia që u vendos në Shqipëri dhe krijimi i ekonomisë së tregut nuk mund të trashëgonin dhe as të adaptonin asnjë nga ligjet e mëparshme të diktaturës dhe ekonomisë së centralizuar dhe të planifikuar. Gjithçka duhej hartuar nga e para dhe për këtë, më tepër se çdo gjë tjetër, kërkohej kualifikim dhe përvojë e mjaftueshme parlamentare, veçanërisht në procesin ligjvënës. Pikërisht këto dy kërkesa nuk mund të plotësoheshin, duke i marrë të gatshme nga të tjerët. Ato do të ishin vetëm shqiptare sepse deputetët e Kuvendit mund të jenë vetëm shqiptarë dhe sepse vetëm ata do të shqyrtojnë, do të propozojnë amendamente, do të miratojnë ose do të rrëzojnë me votim një projektligj. Meqenëse deputetë të tillë të gatshëm nuk mund të kishte, e vetmja mundësi ishte që përvoja e domosdoshme të fitohej gjatë procesit të vetëdemokratizimit të Shqipërisë. Por jeta politike shqiptare, me veçoritë e tepruara të saj, imponoi ndërrime të shpeshta në Kuvend (4 zgjedhje për 9 vjet), aq sa në Kuvendin e sotëm, vetëm 30% e deputetëve kanë pasur fatin të rizgjidhen, kurse 70% e tyre janë fare të rinj në kuptimin më të plotë të fjalës. Në kushte të tilla, kur në çdo Kuvend të ri shumica dërrmuese e deputetëve, pas betimit, duhet të nisin veprimtarinë e tyre ligjvënëse me leximin dhe përvetësimin e Rregullores së Kuvendit, zor se mund të arrihet që brenda një kohe të shkurtër, madje tepër të shkurtër, të mund të vënë në përdorim të drejtën kushtetuese të iniciativës ligjvënëse.

Konkretizimi i iniciativës ligjvënëse nga ana e deputetit, përveç përvojës parlamentare, kërkon domosdoshmërisht edhe një *background* juridik, politik, ekonomik dhe kulturor të përcaktuar. Formimi i këtij statusi është një proces i gjatë shkollimi, akumulimi informacioni, përpunimi dhe hulumtimi vetjak në një sfond të qendrueshëm demokratik. Të gjitha këto premisa të domosdoshme, me përjashtim të shkollimit bazë parauniversitar dhe universitar, mungonin tërësisht në periudhën e gjatë 45-vjeçare të diktaturës. Ato do të mund të krijoheshin vetëm gjatë demokracisë, periudhë tepër e shkurtër, vetëm 9 vjet deri sot. Por edhe shkollimi nuk luajti ndonjë rol të dukshëm, sepse në Kuvendet e Shqipërisë, për shkak të motiveve të forta politike që determinonin seleksionimin e kandidatëve për deputetë, u bë një përfaqësim krejt i ndryshëm dhe i veçantë nga ai i parlamenteve të vendeve të tjera me demokraci të konsoliduar. Kështu, Kuvendi Shqiptar ka sot vetëm 3% të deputetëve juristë dhe 18% ekonomistë, ndërsa pjesa tjetër janë specialistë të fushave të tjera; përbërje e cila është përafërsisht e njëjtë edhe në legjislaturat e mëparshme që nga viti 1991. Nuk është e vështirë të merret me mend se sa pak shanse kishte që të krijohej te deputetët aftësia profesionale ligjvënëse, dhe për më tepër, të përdorej kjo aftësi për konceptimin, hartimin dhe paraqitjen e projektligjeve që lindnin mbi bazën e iniciativës ligjvënëse që u garanton atyre Kushtetuta.

Deputetëve shqiptarë u kanë munguar edhe disa kushte të tjera që do të favorizonin kualifikimin e tyre si ligjvënës. Skedari i literaturës politike në bibliotekat e Shqipërisë ishte rigorozisht i njëanshëm: vetëm literaturë politike marksiste-leniniste. Ato kurrsesi nuk mund të shërbenin si vendi ku politikanët e rinj shqiptarë të periudhës së demokracisë do të mund të gjenin literaturën e nevojshme për vetaftësimin dhe vetëkualifikimin e tyre, për të përballuar mandej kërkesat që u vinte përpara veprimtaria e tyre parlamentare. Vetëm pas disa vjetësh pas vitit 1991 u arrit të krijohej një bibliotekë deri-diku e specializuar pranë Kuvendit, por përdorimi modest i gjuhëve të huaja perëndimore nga ana e deputetëve, do të përbënte një faktor kufizues për përfitimin e përvojës parlamentare të demokracive euroatlantike.

Pranë Kuvendit, si pjesë e administratës së tij, nuk qe e mundur të krijohej dhe të organizohej një strukturë shërbimi në dispozicion të deputetëve, që të kontribuonte në kualifikimin e përshtetshëm të tyre. Është e vërtetë se shumë projekte të huaja (sidomos ai i IRI-t) dhe mjaft OJQ kanë kryer veprimtari të shumta dhe kanë botuar shumë materiale në shqip, por auditorët e tyre kanë ndryshuar shpesh për shkak të zgjedhjeve politike të shpeshta, duke pakësuar dukshëm efektivitetin e tyre. Edhe vizitat e grupeve të deputetëve në parlamentet e vendeve demokratike nuk i kanë shërbyer aq shumë kualifikimit individual, për shkak të subjektivizmit politik në përbërjen dhe keqorganizimin e tyre. Pra, nuk është e vështirë të merret me mend se sa pak është përfituar nga përvoja parlamentare botërore në nxitjen e iniciativës ligjvënëse të deputetët e rinj shqiptarë.

Duhet përmendur edhe një faktor tjetër me efekt negativ në nxitjen e kësaj iniciative. Kuvendit të Shqipërisë i ka munguar dhe vazhdon t'i mungojë edhe sot një strukturë e posaçme, e cila mund të emërtohej p.sh. byroja juridike, ku të grupoheshin disa juristë me kualifikimin e nevojshëm. Kjo strukturë të shërbente si njësi ku të realizohej këshillimi, promovimi dhe përpunimi i ideve apo iniciativave ligjvënëse të deputetëve, gjithashtu, edhe për transformimin e tyre në projektligje. Është vërtet e pakuptueshme se përse nuk është arritur deri më sot të krijohet ky sektor pranë administratës së Kuvendit.

Një kompjuter vetjak është sot një pajisje e domosdoshme për çdo kabinet, është një instrument real. Por sa kohë që personi që punon në këtë kabinet nuk di ta përdorë atë, kjo pajisje mbetet një instrument formal. Prandaj deputetët shqiptarë duhet të përvetësojnë sa më shpejt dhe sa më mirë të gjithë instrumentet e nevojshme legjivënëse, në mënyrë që të bëhet realitet kjo e drejtë e tyre kushtetuese.

Roli i specialistëve dhe i shoqërisë civile në procesin e hartimit të projektligjeve

Nga Njazi Jaho

Jurist,

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Hartimi i projektligjeve, siç dihet, është një proces sa i rëndësishëm, aq edhe i brishtë. Në hartimin e tyre duhet të ngarkohen specialistët më të mirë. Kam parasysh këtu jo vetëm juristët, por edhe specialistët e fushave të tjera. Kjo ka të bëjë me cilësinë e projektit dhe synimet që nëpërmjet tij mendohet të arrihen. Roli i specialistëve dhe i shoqërisë civile në procesin e hartimit të projektligjeve nuk është një kërkesë që lindi tashti pas miratimit të Kushtetutës, megjithëse ky fakt merr një rëndësi të veçantë.

Pas vitit 1990 dhe sidomos pas miratimit të “Dispozitave kryesore kushtetuese”, filloi procesi i ndryshimit dhe shfuqizimit të legjislacionit të mëparshëm, i hartimit dhe miratimit të ligjeve të reja. Në vitet e para pas përmbyesjes së regjimit totalitar pati një prirje për të mënjanuar specialistët e vjetër, edhe pse të pakompromentuar, me arsyetimin se ata nuk mund t’i shërbenin krijimit të legjislacionit të ri. Më vonë kjo prirje filloi të zbutet.

Demokratizimi i vendit kërkonte edhe rritjen e rolit të shoqërisë civile. Kjo është arsyeja që edhe te ne u krijuan organizatat e para joqeveritare. Mund të përmendim këtu Forumin e të Drejtave të Njeriut, që u krijua në dhjetor 1990 dhe që më vonë u emërtua Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Megjithatë, me disa përjashtime, roli i organizatave joqeveritare në vitet e para të vendosjes së pluralizmit politik ndihej relativisht pak, ndërsa

pjesëmarrja e tyre në hartimin e projektligjeve ishte e zbehtë. Kjo ndoshta ka të bëjë edhe me mungesën e përvojës, si dhe me konceptimin e këtij procesi.

Problemet e shumta dhe të ndërlikuara, si dhe nevoja për miratimin e ligjeve të reja, deri në një farë mase ndikuan edhe në mungesat dhe defektet që u vërtetuan gjatë fazës së hartimit të disa projektligjeve. Një pjesë e mirë e tyre u përgatitën nga grupe tepër të ngushta specialistësh. Në këtë proces nuk u arrit të shmangej edhe ndonjë ndikim i karakterit politiko-partiak.

Brenda një kohe relativisht të shkurtër u hartuan dhe u miratuan kodet e reja, por projektet e tyre nuk u bënë objekt diskutimi dhe debati në rrethe të gjëra të specialistëve, ndërsa mendimi i organizatave joqeveritare u anashkalua krejtësisht. Kjo ndodhi sepse ekzistonte paragjykimi: “e po çfarë mund të na japin ato”, kur dihet se në këto kode ka mjaft dispozita që kanë lidhje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me të drejtat dhe liritë e shtetasve. Për specialistët ishte i pakonceptueshëm fakti që një kod i rëndësishëm, siç është për shembull Kodi Civil, u miratua brenda 8 orëve në Kuvend, ndërsa shumë dispozita të Kodit të Punës, të përgatitura nga një profesor zviceran, nuk u kuptuan as nga specialistët, as nga sindikalistët dhe as nga ata që janë në marrëdhënie pune dhe që dëmtohen për shkak të paqartësive që ekzistojnë në këtë Kod.

Shpesh thuhet se ne nuk vuajmë nga mungesa e ligjeve, por nga moszbatimi i tyre. Kjo është e drejtë, ndërsa unë do t'i shtoja kësaj edhe diçka tjetër. Konkretisht, shumë nga defektet, që vërtetohen në ligjet e miratuara kanë të bëjnë me fazën e hartimit, ku ka pasur ose nxitim ose projektet nuk janë bërë objekt diskutimi dhe debati në rrethe të gjëra juristësh, se nuk është vlerësuar si duhet edhe ndihmesa që mund të jepnin në këtë drejtim përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Nxitimi në hartimin e projektligjeve në raste të veçuara ka kaluar deri atje sa ato t'i paraqiten drejtpërdrejt Kuvendit me nismën e deputetëve, duke mos marrë fare mendimin e specialistëve, duke mos u shqyrtuar ato as nga Ministria e Drejtësisë dhe as nga Këshilli i Ministrave. Tipik ishte

rasti i një projektligji që u paraqit drejtpërdrejt në Kuvend në dhjetor të vitit 1996 për ndryshime në Kodin Penal. Rreth 70 dispozita të këtij Kodi u ndryshuan dhe, në vend të masave alternative të dënimit, u caktuan masa fikse (maksimale) absolute. Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në shkurt të vitit 1997, edhe pse nuk ishte subjekt i legjitimuar, iu drejtua Gjykatës Kushtetuese me sugjerimin për t'i deklaruar të gjitha këto ndryshime antikushtetuese dhe që bien ndesh edhe me Pjesën e Përgjithshme të Kodit Penal. Në maj të vitit 1997 Gjykata Kushtetuese vendosi ta deklarojë antikushtetues këtë ligj.

Kemi përshtypjen se këto vitet e fundit, po tregohet një interes më i madh qysh në fazën e hartimit të projektligjeve. Specialistët jo vetëm thirren për të shfaqur mendimet e tyre, por angazhohen edhe drejtpërdrejt me hartimin e këtyre projekteve. Vërehet, gjithashtu, një qëndrim më pozitiv edhe ndaj organizatave joqeveritare. Kjo u duk p.sh., në hartimin, diskutimin dhe debatin e projekt-kushtetutës.

Komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në mënyrë të veçantë ai i ligjeve, i SHIK-ut dhe Rendit kanë bashkëpunuar me organizatat joqeveritare në diskutimin e projektligjit për SHIK-un, për grumbullimin e armëve, për SHIR-in, për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë etj. Organizatat joqeveritare kanë dhënë, gjithashtu, ndihmesën e tyre modeste edhe për projektligjet “Për Avokatin e Popullit”, “Për Statusin e Nëpunësit Civil”, “Për të drejtën e informimit”. Një punë të mirë mendoj se ka bërë në këtë drejtim edhe Instituti i Studimeve Bashkëkohore.

Pranë Ministrisë së Drejtësisë aktualisht funksionojnë disa komisione. Punohet për ndryshime dhe përmirësime të nevojshme në Kodin Penal, në Kodin Civil etj. Nuk ka dyshim se kjo është një nismë serioze dhe e rëndësishme. Në këto komisione janë angazhuar specialistë të mirë dhe me përvojë. Megjithatë, mendoj se puna e këtyre komisioneve do të ishte më rezultative në qoftë se ose do të mbështeteshin në studime ose përgjithësim të periudhës nga miratimi i kodeve deri më sot. Druaj se projektet për ndryshimin e kodeve mund t'i dërgohen qeverisë para se ato të jenë bërë

objekt diskutimi dhe debati në rrethet e gjëra të specialistëve, në radhë të parë të juristëve dhe, si rrjedhim, pa dëgjuar fare edhe mendimet e përfaqësuesve të shoqërisë civile. Në këtë drejtim ka përvojë negative, çka na detyron ta ngremë paraprkishtë këtë çështje, me shpresë se gabimet e së kaluarës nuk do të përsëriten. E theksoj këtë edhe për faktin se, sipas njoftimeve të shtypit, Kuvendit i është dërguar projektligji për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Penale dhe në Kodin e Procedurës Civile. Thuhet se, pas miratimit të këtij projekti, gjykimet do të bëhen me tre gjyqtarë, ndërsa do të ketë edhe çështje që do të gjykohen me një gjyqtar. Veç kësaj, ndihmësgjyqtarët do të testohen dhe do të emërtohen si gjyqtarë, ata që do të konsiderohen të aftë për ta kryer këtë detyrë, d.m.th ata që do të plotësojnë kushtet për të qenë gjyqtarë.

E ngre këtë çështje jo për të shfaqur mendimin nëse kjo nismë është e nevojshme ose jo, nëse këto ndryshime i dikton praktika ose jo, por për të evidentuar faktin se ndryshime të tilla do të ishte mirë të diskutoheshin në rrethe të gjëra juristësh, gjyqtarësh, prokurorësh, avokatësh etj., pse jo edhe me përfaqësues të organizatave joqeveritare. Po të bëhej i qartë qëllimi i këtyre ndryshimeve dhe nevoja e ngutshme për t'i bërë ato, mendimet sugjerimet ose vërejtjet që do të bëheshin, mund t'i shërbenin hartimit të një projektligji më të plotë dhe më të saktë. E theksoj këtë edhe për faktin se kjo çështje ka të bëjë me organizimin gjyqësor, se është element përbërës i reformës në drejtësi.

Kam, gjithashtu, mendimin se ende ndeshemi me konceptin (në ndonjë rast edhe të kamufluar) se ne kemi përvojën e vendeve të tjera, se projektet janë hartuar nga specialistë të mirëfilltë, se organizatat joqeveritare nuk janë të atij niveli sa të japin ndihmesë në formulimin e kësaj ose asaj dispozite etj. Këto koncepte janë sa të gabuara, aq edhe frenuese. Të gabuara, sepse me gjithë rëndësinë që ka përvoja që merret nga vendet e tjera demokratike, ne na duhet të njohim kushtet e vendit tonë dhe të mos bëjmë përshtatje mekanike; frenuese, sepse mendimi i disa specialistëve, qofshin të aftë, nuk është në gjendje të njohë dhe të reflektojë gjithçka që dikton praktika. Veç

kësaj, konceptet e mësipërme në lidhje me organizatat joqeveritare, tregojnë mosvlerësimin e rolit të tyre në një shoqëri civile që ne mundohemi të ndërtojmë.

Lidhur me rolin e shoqërisë civile në hartimin e projektligjeve, mendoj se duhen pasur parasysh sugjerimet e mëposhtme:

Së pari, pjesëmarrja e tyre duhet të konsiderohet e domosdoshme, sidomos në ato projekte ku trajtohen probleme që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë e shtetasve. Kjo praktikë nuk duhet të jetë spontane. Për këtë është e nevojshme të ketë planifikim, d.m.th të jetë pjesë përbërëse e metodës së organeve shtetërore.

Së dyti, në pjesëmarrjen e shoqërisë civile nuk duhet të ketë formalizma. Kjo do të thotë se ajo duhet të jetë e informuar rregullisht dhe paraprakisht me axhendën e problemeve objekt-diskutimi. Ka pasur edhe ndonjë rast kur përfaqësues të organizatave joqeveritare janë njoftuar një ditë më parë, madje po atë ditë që ka qenë caktuar diskutimi i projektit. Tashti të tërheq vëmendjen fakti se, nën vëzhgimin e OSBE-së, po diskutojnë së bashkë specialistët e pozitës dhe të opozitës për ndryshime në Kodin Zgjedhor. Kuptohet se kjo i shërben arritjes së konsensusit të nevojshëm midis forcave politike. Por bëhet pyetje: A do t'u krijohet mundësia specialistëve dhe shoqërisë civile të diskutojnë dhe të debatojnë lidhur me dispozitat e këtij projekti kaq të rëndësishëm? Përse pjesë të këtij Projekti të mos botoheshin paraprakisht, duke u njohur kështu edhe me mendimin e të tjerëve? E shpreh këtë mendim jo vetëm për Kodin Zgjedhor, po edhe për projektligje të tjera të rëndësishme, me qëllim që njerëzit të mos marrin vesh për to, kur i dërgohen Qeverisë ose kur miratohen nga Kuvendi.

Kohët e fundit janë shfaqur mendime për një organizim të ri të gjykatave të apelit, për reduktimin e tyre nga 6 në 3, që gjykatat e rretheve të kenë të drejtën e gjykimit në të gjithë juridiksionin e gjykatave të apelit. Ka, gjithashtu, mendime për krijimin e gjykatave që do të organizohen posaçërisht për gjykimin e krimeve të rënda. Ç' duhet bërë? Si duhet vepruar? A nuk duhet që këto mendime, që mund të jenë të drejta dhe aktuale, të

shoqërohen me përgjithësime, studime, të bëhen objekt diskutimi në tryeza të rumbullakta me pjesëmarrjen e specialistëve dhe të pëfaqësuesve të shoqërisë civile? Po të veprohej në këtë mënyrë, do të parandalohej praktika e gabuar e rasteve të veçanta, që pa një studim, diskutim dhe debat konstruktiv, vetëm pse dikush ose disa e ngrenë këtë ose atë çështje, kalohet në hartimin e projektligjeve, kur dihet se hartimi vetëm i një projektligji nënkupton njohjen e realitetit jo në sipërfaqe, por në thellësi dhe detaje.

Sipas njoftimeve të shtypit është hartuar projektligji për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor, si dhe një projektligj për ndarjen administrative të vendit. Kuptohet se hartimi i projekteve të mësipërme është i nevojshëm, aq më tepër edhe për faktin se këtë e kërkon Kushtetuta. Por a do të bëhen këto projekte, sidomos i pari objekt diskutimi dhe debati, apo në do të informohemi për to kur t'i dërgohen për miratim Kuvendit? Përse ato nuk publikohen? Përse nuk organizohen emisione televizive? Punonjësit e administratës publike, specialistët e ndryshëm, por edhe shtetas të veçantë mund të japin ndihmesë në përmirësimin e tyre. Mund të thuhet, me këtë rast, se ka organizata joqeveritare, midis tyre edhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit, që kanë kryer vëzhgime se si funksionojnë organet e pushtetit vendor, veçanërisht në drejtim të plotësisimit të kërkesave dhe ankesave të shtetasve, madje, në mbështetje të të dhënave të këtyre vëzhgimeve është arritur edhe në disa përfundime.

Problemet janë të shumta. Jeta dhe praktika na bindin se në hartimin e projektligjeve duhet treguar kujdes më i madh. Kjo ka lidhje të drejtpërdrejtë me miratimin e ligjeve të qarta dhe të sakta që të mos u lihet shteg keqinterpretimeve. Nuk do të ishte serioze që, menjëherë sa miratohet një ligj, të dalë nevoja e propozimeve për ndryshimin e tij. Në këto raste defekti është i lidhur me punën e pathelluar qysh në fazën e hartimit të projektit.

Informacion mbi veprimtaritë e organizmave ndërkombëtare

Nga Leon Shestani

Ajo çka ndodh në asambletë e ndryshme europiane dhe më gjerë, prek ndjeshëm zhvillimet në vendin tonë dhe në rajon. Në një garë informacioni, ku lajmet dhe transkriptet e takimeve lëvizin në kohë reale, shpeshherë ndeshemi me situata paradoksale, ku vendimmarrësit diskutojnë mbi tekste ose dokumenta për të cilat kanë dëgjuar vetëm komente ose lexuar nga shtypi i përditshëm vetëm ekstrakte, por nuk kanë mundësinë të lexojnë tekstet përkatëse dhe, për rrjedhim, të krijojnë një opinion tërësisht të tyre.

Natyrisht që një rubrikë e një reviste pothuaj të përmuajshme nuk e zgjidh këtë problem, sepse një javë vonesë është tepër në vendimmarrje, vecanërisht në diplomaci, por tenton që të ofrojë sadopak një referencë për dokumentet e rëndësishme që diskutohen në asambletë e ndryshme, sidomos për ato që lidhen drejtpërdrejt me vendin tonë ose rajonin.

I. Rajoni - zhvillimet në Kosovë: Korniza Kushtetuese, zgjedhjet parlamentare

Kosova tashmë ka kornizën ose kuadrin e vet kushtetues. 17 nëntori shënon datën e zgjedhjeve parlamentare që do ta çojnë Kosovën drejt të ashtuquajturës qeverisje substanciale.

Si jo rrallë në hapësirën politike shqiptare, nënshkrimi i dokumenteve të rëndësishme, që në çdo mënyrë janë kalimtare për Kosovën, shoqërohet me elemente ndarjeje dhe nuk shërben si element bashkimi në funksion të synimeve finale.

Kuadri kushtetues, i firmosur nga Kryeadministratori i Kosovës dhe shumica e anëtarëve të Këshillit Kalimtar, përbën një mjet drejt përvojave pa precedent për kosovarët – vetëqeverisjen dhe, në të njëjtën kohë, nuk del nga kuadri i Rezolutës 1244. Nuk mund të ishte ndryshe. Vetëdija për këtë, pavarësisht nga diferencat dhe dëshirat për tekstin e saj, duhet të sundojë në të gjithë faktoret politikë shqiptarë. Përdorimi për efekte zgjedhore i çasteve të tilla të rëndësishme mund të çojë në deficite të paimagjinueshme atëherë kur kuadri i Rezolutës 1244 do të rishqyrtohet dhe ku do të jetë thelbësor elementi i koherencës së pozicioneve të faktorit shqiptar. Megjithatë, kjo ngjarje do të hapë rrugën e zgjedhjeve parlamentare, ku të gjithë faktorët politikë kanë shprehur vullnetin e tyre për të marrë pjesë.

NËNSHKRUHET KORNIZA KUSHTETUESE E KOSOVËS

Shefi i misionit civil të OKB-së në Kosovë, Hans Hakerup, ka nënshkruar dokumentin më të lartë juridik në Kosovë, atë të Kornizës Kushtetuese. Këtë dokument e kanë nënshkruar edhe dy nga pjesëmarrësit shqiptarë në KPA Ibrahim Rugova (LDK) dhe Ramush Haradinaj (AAK), ndërkohë që anëtari tjetër, Hashim Thaçi (PDK) nuk ka pranuar ta nënshkruajë këtë dokument, por ka deklaruar se do të marrë pjesë në proceset demokratike në Kosovë në të ardhmen. Thaçi nuk është pajtuar me dokumentin dhe nuk ka nënshkruar, sepse në këtë dokument nuk janë përfshirë pesë kërkesat e shqiptarëve e, në veçanti, ajo e referendumit dhe se Korniza Kushtetuese fillimisht ka marrë pëlqimin nga Beogradi zyrtar.

“Ne kemi pasur disa rezerva për dokumentin - tha dr. Ibrahim Rugova, - por megjithatë ne vendosëm që ta përkrahim këtë dokument për të çuar përpara proceset e filluara në Kosovë. Rezerva kryesore është referendumi”. Ky dokument është më tepër për zgjedhjet e përgjithshme dhe LDK-ja do të marrë pjesë në proces. Ramush Haradinaj tha se “me qëllim të ecjes përpara kemi vendosur ta përkrahim këtë dokument”. Si arsye për përkrahjen dokumentit ai theksoi se mungesa e institucioneve e rëndon jetën në Kosovë dhe e shpejton kalimin e përgjegjësive nga ndërkombëtarët, te populli i

Kosovës. Haradinaj tha se zotohet për formimin e institucioneve të mirëfillta në Kosovë.

Përfaqësuesit politikë serbë të Kosovës kanë shprehur pakënaqësi për Kornizën Kushtetuese të Kosovës. Njëri nga ata, Momçillo Trajkoviqi, thotë se “kërkesat tona minimale janë se Kosova nuk mund të bëhet e pavarur”. Trajkoviqi akuzoi, siç u shpreh, “mbeturinat e administratës” së kaluar amerikane, të cilat dëshirojnë të shfrytëzojnë periudhën e tranzicionit dhe të realizojnë atë që u kanë premtuar shqiptarëve, dhe kjo është pavarësia e Kosovës”. Ndërkaq, anëtari serb në ekipin për hartimin e Kornizës Kushtetuese për vetëqeverisjen në Kosovë, Aleksandër Simiq thotë se bashkësia ndërkombëtare u është nënshtruar presioneve të shqiptarëve. Aktualisht Beogradi nuk ka reaguar zyrtarisht rreth shpalljes së zgjedhjeve të përgjithshme në Kosovë dhe në lidhje me Kornizën Kushtetuese.

Hans Hakerup, Administrator i Kosovës vlerësoi se ideja e çështjes së përfshirjes së tre drejtës të popullit të Kosovës për vetëvendosje pas periudhës kalimtare, pikë kjo, më e ndjeshmja dhe në të cilën kanë këmbëngulur shqiptarët, është kundërshtuar nga të gjitha shtetet europiane.

Hakerup theksoi se dokumenti i Kornizës Kushtetuese është një dokument i përkohshëm, që garanton bartjen e një pjese të pushtetit në duart e kosovarëve. Me këtë dokument është pajtuar edhe përfaqësuesja e minoritetit serb, Rada Trajkoviqi, e cila edhe e ka nënshkruar atë.

ZGJEDHJET PARLAMENTARE

Kryeadministratori i Kosovës shpalli 17 nëntorin 2001 si datë të zhvillimit të zgjedhjeve të përgjithshme në Kosovë. Dokumenti, i cili do të mundësojë mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme, do të quhet korniza kushtetuese e Kosovës për Vetadministrim të Përkohshëm. Grupi i përbashkët i punës, gjatë shtatë javësh ka krijuar një tekst kuptimplotë, duke lënë vetëm disa çështje të hapura politikisht të ndjeshme.

Korniza Kushtetuese u siguron të drejtat të gjitha bashkësive dhe përfaqësimin e tyre në të gjitha institucionet që do të krijohen. Do të ketë

një referencë në dokument, sipas të cilës vullneti i popullit do të merret parasysh krahas faktorëve të tjerë relevantë në proces, të cilët në përputhje me Rezolutën 1244, do të përcaktojnë statusin përfundimtar të Kosovës në një fazë të përshtatshme në të ardhmen. Korniza Kushtetuese siguron kalimin e pushtetit nga ndërkombëtarët te organet e zgjedhura të Kosovës.

Në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare më 17 nëntor qytetarët e Kosovës do të zgjedhin Parlamentin e Kosovës i cili do të ketë 120 vende. Prej tyre 100 vende do të jenë për partitë që fitojnë në zgjedhje, 10 vende nga numri i përgjithshëm janë të rezervuara për përfaqësuesit serbë, ndërsa 10 vende të tjera për pjesëtarët e pakicave të tjera në Kosovë.

Kryesia e Parlamentit do të ketë shtatë anëtarë. Njëri nga të cilët do të jetë serb dhe një tjetër i pakicave të tjera. Po sipas dokumentit, Kosova do të ketë edhe president, qeveri dhe kryeministër. Presidenti i Kosovës do të zgjidhet nga Parlamenti, i cili do ta përfaqësojë Kosovën dhe do të garantojë funksionim demokratik të vetadministrimit.

Misioni i OKB-së do të vazhdojë të qëndrojë në Kosovë dhe roli kryesues i këtij Misioni do të jetë i madh e do të sigurojë që të gjitha aktet e vetadministrimit të jenë në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Misioni ndërkombëtar do të jetë përgjegjës edhe për drejtësinë dhe zbatimin e ligjit edhe nga Trupat Mbrotjtëse të Kosovës.

Një fillim i mbarë...

Nga Zana Bufi

Kuvendi,

Sektori i Kërkimit dhe Biblioteka

Më në fund pas një heshtje mbi gjysëm shekullore, publiku shqiptar u njoh me diskutimet e zhvilluara nga deputetët në Kuvendin e Shqipërisë, në vitet e vështira të tranzicionit politik që po kalon Shqipëria. Këto diskutime titullohen: **“Punime të Kuvendit”**.

Me fillimin e botimit të **“Punime të Kuvendit”**, Kuvendi i Shqipërisë, shprehu vullnetin e tij politik nga njera anë, dhe nga ana tjetër plotësoi detyrimin e tij ligjor të përcaktuar në Kreun V të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë: Hapja dhe Publiciteti i Mbledhjeve të Kuvendit, neni 38. Ky botim, merr rëndësi të veçantë sidomos në kuadrin e së drejtës për informim të publikut me transparencë të plotë. Vonesat e deritanishme në përmirësimin e kësaj transparence, kishin krijuar një boshllëk, i cili dëmtonte objektivat e shtetit të së drejtës në Shqipëri.

Mbushja e këtij boshllëku do të ndihmojë në edukimin i klasës së politikanëve me mënyrën e interpretimit të ligjeve. Në debatet e zhvilluara në seancat plenare, pasqyrohet diskutimi i projektligjeve të ndryshme, mënyra e ushtrimit të kontrollit parlamentar, që realizohet nëpërmjet pyetjeve, interpelancave, mocioneve për debat, mocionit të besimit dhe mocionit të mosbesimit. Në të njëjtën kohë, botimi i debateve të zhvilluara në seancat plenare, i rezervon të drejtën historisë të gjykojë dhe vlerësojë kontributin e politikanëve në hedhjen e themeleve për zhvillimin ekonomik dhe emancipimin shoqëror të kombit tonë.

Si një dokument i rëndësishëm parlamentar, ai përbën një kontribut të rëndësishëm dhe një mundësi më shumë për studjuesit e fushave të ndryshme

të së drejtës, si edhe për punonjësit që merren me dokumentimin e informacionit parlamentar.

Duke qenë dokumenti parlamentar bazë i Kuvendit, botimi në fjalë, do të shërbejë në të njëjtën kohë si një kronikë e dokumentuar e jetës parlamentare në Shqipërinë post-komuniste, duke vazhduar traditën e herëshme të institucionit të parlamentarizimit në Shqipëri, që i ka fillimet e tij në 21 Prill të vitit 1921. Parlamenti i dalë nga zgjedhjet parlamentare të shkurt-marsit 1921, luajti një rol të rëndësishëm në reformën e legjislacionit shqiptar, që synonte të zëvendësonte legjislacionin otoman që ende vepronte në Shqipëri. Botimet e diskutimeve në parlament titulloheshin: *Bisedimet e Këshillit Kombëtar*, *Bisedimet e Dhomës së Deputetëve*, *Bisedimet e Senatit*, *Bisedimet e Asamblesë Legjislative*, *Bisedimet e Parlamentit*.

Është për t'u përsëritur Sektori i Botimeve të Kuvendit të Shqipërisë, punonjësit e të cilit punuan me përkushtim, që publiku sot të ketë në dorë këtë botim me vlerë.

Modernizimi i mëtejshëm i këtij proçesi, sigurimi i infrastrukturës së nevojshme teknike, do të bëjë të mundur botimin brenda javës të diskutimeve të Kuvendit, praktikë kjo e parlamenteve të tjera nacionale, mbetet një detyrë për të ardhmen.

Anarchy, opposite of freedom of media

By Halil Lalaj

MPs,

*Chief of Parliamentary Committee
for Means of Public Information*

